

**SHEMBUJT THJESHTOJNË ZBATIMIN E UDHËZIMIT NR. 15, 23.12.2011 PËR
"PËRPUNIMIN DHE PUBLIKIMIN E TË DHËNAVE PERSONALE NË SISTEMIN
GJYQËSOR"**

Shembull 1

Pranë Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale është paraqitur ankesa e shtetasit "X". Ankesa e shtetasit, subjekt i të dhënave personale, e cila **konsistente në publikimin e vendimit** nr.10xx datë xx.xx.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në të përditshmen "*Gazeta Shqiptare*", vendim i cili mbart të dhëna personale të tij.

Gjithashtu ky vendim është publikuar në faqen zyrtare në internet të gjykatës, ashtu siç është në dosjen fizike të çështjes pa marrë masat e duhura për bërjen anonime të të dhënave personale të subjekteve që përfshihen në këtë vendim. Qëllimi i publikimit të këtij vendimi gjyqësor ishte transparenca dhe informimi publik.

Komisioneri në këtë rast ka vlerësuar se duke bërë publike të dhënat personale të subjekteve të përfshira në këtë vendim shkelet privatësia e këtyre subjekteve të të dhënave personale, nuk respektohen dhe garantojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe në veçanti e drejta e ruajtjes së jetës private, të drejta të cilat janë të mbrojtura nga neni 8 i Konventës Evropiane për "*Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut*" si dhe ligji nr. 9887 datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*".

Sa më sipër publikimi i këtij vendimi bie në kundërshtim me:

- **Nenin 2** të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" ku parashikohet se *përpunimi i ligjshëm i të dhënave personale bëhet duke respektuar dhe garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe në veçanti të drejtën e ruajtjes së jetës private*".
- **Kreun IV** "Publikimi i të Dhënave Personale" i Udhëzimit Nr.15 datë 23.12.2011 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale "Për Përpunimin dhe Publikimin e të Dhënave Personale në Sistemin Gjyqësor",

Në funksion të zgjidhjes së ankesës Komisioneri ka realizuar inspektimin përkatës dhe konstatoi, gjithashtu se nga kontrolluesi "Gjykata e Rrethit Gjyqësor" Tiranë nuk janë marrë masat e duhura teknike e organizative për zbatimin e Udhëzimit nr.15 datë 23.12.2011 i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale "Për Përpunimin dhe Publikimin e të Dhënave Personale në Sistemin Gjyqësor".

Në këto kushte, në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, si dhe neneve 107-109 të K. Pr. Administrative, Komisioneri urdhëroi:

1. Në zbatim të nenit 2 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” dhe Kreut IV të Udhëzimit nr.15 datë 23.12.2011 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale “Për Përpunimin dhe Publikimin e të Dhënave Personale në Sistemin Gjyqësor”, të bëhet anonimizimi i të dhënave personale që i përkasin subjekteve të përfshira në Vendimin nr.10xx datë xx.xx.2012 të publikuar në faqen e tyre zyrtare në internet.
2. Të merren të gjitha masat e duhura teknike dhe organizative për zbatimin e Udhëzimit nr.15 datë 23.12.2011 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale “Për Përpunimin dhe Publikimin e të Dhënave Personale në Sistemin Gjyqësor” për të realizuar anonimizimin e të dhënave personale që i përkasin subjekteve të përfshira në vendimet gjyqësore që publikohen në faqen zyrtare në internet.

Shembull 2

Pranë Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale është paraqitur ankesa e shtetasit “Y” e cila lidhet **me mbrojtjen e të dhënave personale gjatë shpërndarjes së fletë-thirrjes** (të shoqëruara me kërkesë paditë) të shtetasve.

Kontrolluesi “Gjykata e Rrethit Gjyqësor” Tiranë në funksion të kryerjes së detyrës së saj bazuar në Kodin e Procedurës Civile nenet 128 e vazhdim, realizon thirrjen e personave me anë të nëpunësit gjyqësor. Thirrja në gjykatë bëhet me letërthirrje e cila përmban të dhëna personale si: emrin, mbiemrin e personit të thirrur, kohën e vendin e seancës gjyqësore, mosmarrëveshjen për të cilën thirret, si dhe pasojat ligjore në rast se personi i thirrur nuk paraqitet në gjykatë. Letërthirrja dhe dokumentet që shoqërojnë atë (*kërkesa, kërkesë-padi etj*) shpërndahen dhe dorëzohen të hapura (*jo të mbyllura në zarf*) nga punonjësit e Kontrolluesit.

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale vlerësoi se, nga aplikimi i kësaj procedure aksesi në të dhënat personale të subjekteve që mbarten në këto dokumente realizohet lehtësisht nga persona të tretë (*fajinjët, punonjësit qendrës së punës ku punon i thirruri apo edhe ato të vendbanimit të tij*), **duke shkaktuar një cënim flagrant të të drejtave të subjekteve të të dhënave personale duke shkelur privatësinë e këtyre subjekteve.**

Kontrolluesi gjatë aktivitetit të tij ligjor duhet të garantojë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe në veçanti të drejtën e ruajtjes së jetës private, e drejtë e cila është e mbrojtur nga neni 8 i Konventës Evropiane për “Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut” si dhe ligji nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar.

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale vlerëson se duke mos marrë masa për të mbrojtur aksesin në të dhënat personale të subjekteve që thirren për të marrë pjesë në proceset gjyqësore, shkelet privatësia e këtyre subjekteve të të dhënave personale.

Shpërndarja e letërthirrjeve dhe dokumenteve gjyqësore (*kërkesa, kërkesë-padi etj*) të hapura nuk mbron të dhënat personale të subjekteve që marrin pjesë në proceset gjyqësore.

Kontrolluesi “Gjykata e Rrethit Gjyqësor” Tiranë gjatë procedurës së shpërndarjes së letërthirrjeve dhe dokumenteve gjyqësore (*kërkesa, kërkesë-padi etj*) të hapura është në shkelje të:

- **Neñit 2** të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*” ku parashikohet se *përpunimi i ligjshëm i të dhënave personale bëhet duke respektuar dhe garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe në veçanti të drejtën e ruajtjes së jetës private*”.
- **Pikës 1 të nenit 27**, të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*” ku parashikohet se “*Kontrolluesi ose përpunuesi merr masa organizative dhe teknike të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrime të paligjshme, aksidentale, humbje aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar, veçanërisht kur përpunimi i të dhënave bëhet në rrjet, si dhe nga çdo formë tjetër e paligjshme përpunimi*”.
- **Kreut III** “*Masat e sigurisë së të dhënave personale dhe konfidencialiteti*” të Udhëzimit Nr. 15 datë 23.12.2011 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale “*Për Përpunimin dhe Publikimin e të Dhënave Personale në Sistemin Gjyqësor*”

Në këto kushte, në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, si dhe neneve 107-109 të K. Pr. Administrative, Komisioneri ka urdhëruar:

1. Në zbatim të nenit 27 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*” i ndryshuar dhe Kreut III “*Masat e sigurisë së të dhënave personale dhe konfidencialiteti*” të Udhëzimit nr.15 datë 23.12.2011 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale “*Për Përpunimin dhe Publikimin e të Dhënave Personale në Sistemin Gjyqësor*”:
 - Të pezullohet menjëherë shpërndaja e letërthirrjeve dhe dokumenteve shoqëruese për subjektet që marrin pjesë në proceset gjyqësore sipas procedurës aktuale (*të pa mbyllura në zarf*).
 - Të merren të gjitha masat e duhura teknike dhe organizative për mbrojtjen e aksesit në të dhënat personale të subjekteve që marrin pjesë në proceset gjyqësore, gjatë procedurave të shpërndarjes të letërthirrjeve dhe dokumenteve gjyqësore (*kërkesa, kërkesë-padi etj*), duke bërë mbylljen në zarf të tyre për secilin subjekt.
2. Për plotësimin e këtij detyrimi të njoftohet me shkrim pranë Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
3. Në rast mospërbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*”, sipas të cilit... “*Komisioneri në rast shkeljesh serioze të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të rekomandimeve të tij, vepron sipas nenit 39 të këtij ligji dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave*”.